

UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË

UNIVERSITETI I MJEKËSISË TIRANË

FAKULTETI I MJEKËSISË

TEMË

Përmirësimi i trajtimit adjuvant në kancerin e gjirit të operueshëm .Roli i biomarkerave indore në përzgjedhjen e trajtimit në drejtim të trajtimit të individualizuar .

Disertanti

Dr Alketa Pere

Shërbimi Onkologjik

UDHËHEQËS SHKENCOR

Prof Shahin Kadare

Abstrakt

Terapia adjuvante në kancerin e gjirit aplikohet pas trajtimit kirurgjikal dhe ka si qëllim të reduktojë riskun e rekurencave (rishfaqjes) (lokale dhe në distancë) si dhe të përmirësojë mbijetesën e sëmundjes. Radioterapia realizohet për të reduktuar riskun e rekurencës lokale. Radioterapia e gjithë gjirit konsiderohet standarti i artë pas kirurgjisë konservuese të gjirit për kancerin invaziv dhe konsiderohet gjithashtu pas mastektomisë, në varësi të faktorëve patologjikë të riskut të rikthimit të sëmundjes. Terapitë sistemike (kimioterapia, terapia endokrine dhe biologjike) reduktojnë riskun e metastazave në distancë dhe përmirësojnë mbijetesën e përgjithshme.

Vendimi për të filluar terapinë adjuvante është kompleks (duke marrë parasysh faktorët prognostikë të lidhura me tumorin dhe të pacientit dhe realizohet në një skuadër multidisciplinare. Në praktikën e sotme klinike, në marrjen e këtyre vendimeve ndihmojnë edhe mjete për të llogaritur riskun dhe përfitimet. Avancimet më të avancuara në terapinë sistemike dhe teknikat e radioterapisë kanë drejtuar drejt trajtimit të personalizuar të pacientëve, me qëllim reduktimin akoma më shumë të mortalitetit dhe përmirësimin e kualitetit të jetesës.

Fjalët kyçe: kanceri i gjirit, terapia adjuvante, radioterapi, kimioterapi, terapia hormonale target.

1 .Hyrje

1. Të dhëna të përgjithshme rreth kancerit të gjirit .

2.1 .Stadifikimi i sëmundjes

2.2 Klasifikimi histopatologjik i kancerit të gjirit

2.3. Të dhëna rreth trajtimit lokoregjional

2.4 Roli i trajtimit sistematik në menagjimin e sëmundjes pas trajtimit kirurgjikal

2.5 Të dhëna mbi kimioterapinë adjuvante dhe terapinë targetuese

2.6 Të dhëna mbi trajtimin hormonal .

2.4 Alteracionet molekulare në kancerin e gjirit.

2.7 Ndjekja pas trajtimit primar. Rekomandimet

2.8 Definicioni i rekurences pas trajtimit primar

3 .Qellimi i studimit

4. Materiali dhe metodika

4.1 Analiza statistikore

4.2 Popullata e marrë në studim

5. Rezultatet

6. Diskutimi

7. Konkluzioni

8. Referencat

Objektivat e studimit

- 1 .Vlerësimi i riskut të relapsit (rikthimit të sëmundjes) pas trajtimit kirurgjikal, raporti i rrezikut / përfitimit, preferencat e pacientit në përzgjedhjen e terapisë adjuvante të kancerit të hershëm të gjirit pas trajtimit primar kirurgjikal .
2. Faktorët e rëndësishëm prognostik dhe parashikues në vendimmarrjen për terapinë adjuvante.
3. Kuptojmë rolin e trajtimit lokal, trajtimit hormonal, kimioterapisë dhe terapisë targetuese në trajtimin e të kancerit të gjirit pas trajtimit kirurgjikal
4. Trajtimi adjuvant i kancerit të gjirit në të ardhmen në drejtim të trajtimit të individualizuar bazuar në profilin molekular të tumorit .
5. Krahasimi i skemave të kimiotherapise dhe terapisë targetuese në trajtimin adjuvant pas trajtimit kirurgjikal .

1 Epidemiologjia

Kanceri i gjirit është kanceri i dytë më i shpeshtë i diagnostikuar në të gjithë botën, duke përfshirë vendet me të ardhura të ulëta dhe të larta. Incidenca është më e lartë në Amerikën e Veriut, Australi/Zelandë e Re dhe në Evropën Veriore dhe Perëndimore. Ndërsa vendet e Azisë dhe Afrikës Subhariane kanë incidencë më të ulët.^{3} Këto dallime ka të ngjarë të jenë të lidhura me ndryshimet shoqërore si rezultat i industrializimit (psh ndryshimet në marrjen e yndyrnave në dietë, pesha trupore, mosha e menarkës, laktacioni, modelet e riprodhimit : shtatëzani më të pakëta dhe në moshë më të madhe). Studimet në modelet e emigracionit në SHBA janë në përputhje me rëndësinë e ndryshimeve kulturore dhe mjedisore. Në përgjithësi , incidenca e kancerit të gjirit është më e lartë në imigrantët e shkallës së dytë dhe rritet më tej në gjeneratën e tretë dhe të katërt të tyre.

Në SHBA në vitin 2019 ishin rreth 268'600 raste të reja të kancerit të gjirit të formës invazive në femra, kundrejt 2670 raste në meshkuj^{.4}

Incidenca e kancerit të gjirit u rrit me shpejtësi nga viti 1980 deri në 1987, më tepër si pasojë e përhapjes së mamografisë si metodë depistuese, që solli rritjen e zbulimit të formave asimptomatike. Pas vitit 1987 rritja e formës invazive të kancerit të gjirit u ngadalësua, vecanërisht në gratë e bardha mbi 50 vjec.

Në dekadat e fundit të shekullit të XX në të gjithë botën u rrit incidenca e kancerit të gjirit, me shifra më të larta të raportuara në vendet perëndimore. Arsytet për këtë trend i atribuohen futjes së mamografisë si metodë depistimi dhe faktorëve të lidhur me stilin e jetesës si : ulja e aktivitetit fizik, rritja e obezitetit apo përdorimi i terapisë hormone zëvendësuese për trajtimin e menopauzës.

Fillimi i shekullit të XXI pa një ulje të rëndësishme të incidencës së kancerit të gjirit në vendet perëndimore. Kjo lidhet ndër të tjera me uljen e përdorimit të terapisë hormonale zëvendësuese.

Në vitin 2018 ishin mesatarisht 2.09 milionë raste të reja të kancerit invaziv në të gjithë botën. Incidenca në femra varionte nga 25.9 raste për 100'000 femra në Azinë Jugore deri në 94.2 për 100'000 në Australi/Zelandën e Re. Ndërsa incidenca në lidhje me grupmoshat varion nga 1.5 raste për 100'000 femra në grupmoshën 20-24 vjec deri në 421.3 raste në 75-79 vjec. 95% të rasteve të reja i përkasin grupmoshës mbi 40 vjec

1.1 Stastika te kancerit te gjirit ne Shqiperi

Kanceri i gjirit është kanceri më i shpeshtë në popullatën e femrave dhe kanceri i dytë që haset më shpesh në popullatën e përgjithshme në Shqipëri. Profili epidemiologjik i kancerit të gjirit në vendin tonë është i ngjashëm me atë të vendeve të tjera me të ardhura të mesme, ku incidenca ka qenë në rritje gjatë tri dekadave të fundit, kryesisht për arsye të rritjes së moshës mesatare, urbanizimit dhe ndryshimeve në stilin e jetesës

Stili perëndimor i jetesës lidhur me praktikën riprodhuese dhe dietën (fertiliteti më i ulët, lindja në moshë më të madhe, ushqyerja për një periudhë më të shkurtër të fëmijës me gji, mbipesha, jeta sedentare, konsumi më i lartë i alkoolit) me shumë gjasa ka ndikuar në rritjen e rrezikut për kancer gjiri në vendin tonë gjatë dekadave të fundit. Prirjet afatgjata të nivelit të vdekshmërisë nga kanceri i gjirit në Shqipëri dëshmojnë një rritje të shpejtë gjatë viteve 1990, rritje e cila ka vijuar edhe në vitet e para të shekullit të 21-të. Nga regjistrat e mjekeve të familjes në të gjithë vendin janë identifikuar 986 raste me kancer gjiri në vitin 2018 kurse shtrimet në spital nga kanceri i gjirit janë dyfishuar nga viti 2009 në vitin 2017. Moshë mesatare e personave në momentin e diagnozës së kancerit të gjirit në Shqipëri është 55 vjeç, dhe moshë mesatare e vdekjes është 76.7 vjeç. Raporti vdekshmëri/incidencë për kancerin e gjirit është 32% për vitin 2018 dhe ka ardhur në ulje gjatë viteve të fundit.

Gjatë viteve të fundit vërehet një rritje e numrit të ekzaminimeve mamografike të kryera në të gjithë vendin (nga 5,216 ekzaminime në vitin 2014 në 15,864 në vitin 2018). Në vitin 2018 mbi 90% e grave 15-49 vjeç raportojnë të jenë të informuara mbi mamografinë (krahasuar me 76.6% në vitin 2009).

Incidenca e standardizuar sipas moshës për kancerin e gjirit në Shqipëri është më ulët se në vendet e Bashkimit Europian por më e lartë se vendet e Mesdheut Lindor, të tilla si: Turqia, Egjipti apo Tunizia .

Niveli i incidencës bruto dhe niveli i vdekshmërisë bruto për këtë kancer në Shqipëri janë përkatësisht rreth 50 dhe 16 për 100 000 gra. Sipas Regjistrat Kombëtar të Kancerit, diagnostikohen rreth 700 raste të reja me kancer gjiri në Shqipëri. Prirja është për një rritje të

lehtë. Krahasoni me vitet para vitit 2015 është i vështirë për arsye të përdorimit vetëm të të dhënave të Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” (QSUT) dhe mungesës së Regjistrit Kombëtar. Në vitin 2018 kishte 708 raste të reja të kancerit të gjirit (Figura 1)




Figura 1. Numri i rasteve të reja me kancer gjiri çdo vit në Regjistrin Kombëtar të Kancerit 2015-2018, ISHP [5]

2. Diagnoza

Kombinimi më efikas për diagnozën e sëmundjeve të gjirit është ekzaminimi klinik, imazherik dhe histologjik.

Ekzaminimi klinik përfshin anamnezën e sëmundjes, kërkimin e faktorëve të riskut dhe ekzaminimin fizik : inspeksionin dhe palpacionin. Ekzaminimi klinik është i pari veprim diagnostik që jep dyshimin për praninë e gjendjes patologjike dhe natyrën malinje të saj [9].

2..1 Imazheria

Mamografia. Është ekzaminimi i gjirit me anën e rrezeve X. Ajo është metoda më efikase për zbulimin e kancerit në fazën paraklinike, mund të zbulojë masa më të vogla se 1 cm që janë të

papalpueshme. Sensibiliteti i kësaj metode varion nga 85-90%. Një mamografi normale nuk e përjshon kancerin.




Figura 2. *Kanceri i gjirit në mamografi [9]*

Ekografia është një ekzaminim plotësues i mamografisë. Ajo diferencon formacionet solide nga ato kistike dhe përcakton përmasat e masës tumorale duke ndihmuar në vlerësimin e përgjigjes ndaj kimioterapisë. Ekografia përcakton sakte lokalizimin e masave të paprekshme por të zbuluara në mamografi, duke mundësuar citologjinë aspirative.

Rezonanca magnetike ka përdorim të kufizuar. Ajo vlen kryesisht për të vlerësuar më mire shtrirjen anatomike të procesit neoplazik përpara operacionit dhe për të dalluar recidivën nga indi cicatricial në gjirin e rrezatuar.

Shintimamografia realizohet nëpërmjet injektimit intravenoz të $Tc\ 99m$. Përdoret në rastet e gjinjve me displazi difuze të theksuar në të cilat mamografia nuk e evidenton kancerin.

PET ka përdorim ende të kufizuar dhe përdoret kryesisht për vlerësimin e limfonodulave aksilare. Ka një sensibilitet 84-95%.

Ekzaminimi histologjik në varësi nga marrja e kampionit ndahet në:

Citologjia aspirative me aqe të hollë (FNA). Kjo metodë është e thjeshtë, jo traumatike për pacientët dhe lejon të diferencohen masat solide nga ato kistike. Për masat solide ka sensibilitet 90-95% për vërtetimin e natyrës malinje. Në 10% të rasteve material i aspiruar është i pavlefshëm për interpretim.

Biopsia e mbyllur (NCB-Needle core biopsy) konsiston në shkeputjen e një fragment nga tumori çka rrit saktësinë e diagnozës së kancerit dhe mundëson vlerësimin e veçorive të tjera biologjike. Fals negativiteti i kësaj metode është shume i ulët rreth 2%.

Biopsia e hapur. Kur metodat e mësipërme nuk konfirmojnë natyrën malinje të lezionit të dyshuar aplikohet heqja kirurgjikale e të gjithë masës [9].

2.2 Diagnostikimi i shtrirjes së procesit neoplazik

Për zbulimin e metastazave eventuale, të pranishme në momentin e diagnozës ose të shfaqura pas trjtimit fillestar të kancerit të gjirit përdoren ekzaminime imazherike dhe laboratorike.

Radiografia e toraksit dhe ekografia hepatike janë ekzaminimet rutinë në të gjitha rastet me kancer të gjirit sepse këto janë organet që preken më tepër nga metastazat dhe jo rrallë janë asimptomatike. Në rast të rezultateve të dyshimta indikohet realizimi i CT torako-abdominal. Shintigrafia kockore ka sensibilitet të lartë në zbulimin e metastazave kockore [7].

2.3 Ekzaminimet laboratorike

Bilanci biokimik nuk është vetëm një rutinë preoperative. Rritja e nivelit të fosfatazës alkaline dhe transaminazave mund të jetë rrjedhojë e prekjes metastatike të heparit, ndërsa hiperkalcemia dhe rritja e fosfatazës alkaline janë tregues të metastazave kockore.

Markuesit tumoralë CA 15-3, CA 125, CEA kanë specificitet të lartë veçanërisht në forma të avancuara dhe me metastaza , ndërsa në stadet fillestare ato rriten rrallë [7]

3 . Stadifikimi TNM

Klasifikimi TNM tregon shtrirjen anatomike të procesit neoplazik nëpërmjet vlerësimit para trajtimit të tre komponentëve të rritjes tumorale : tumorit parësor (T), nyjeve limfatike regjionale (N) dhe metastazave të largëta (M). ky stadifikim ndihmon në planifikimin e mjekimit dhe vlerësimin e rezultateve të tij.

. Stadifikimi TNM i kancerit të gjirit [7]

Stadi 0	Karcinoma in situ (duktale, lobulare, Morbus Paget i papilës pa masë tumorale)
Stadi I	T1(Tumor <2cm) N0 (pa limfonodula regjionale), M0(pa metastaza të largëta)
Stadi IIA	T0(pa tumor parësor), N1(limfonodulë aksilare metastatike të lëvizshme)M0(pa metastaza të largëta) T1N1M0, T2(Tumor >2cm dhe <5cm)N0M0
Stadi IIB	T2N1M0, T3(Tumor>5cm)N0M0
Stadi IIIA	T0N2(Limfonodula aksilare të fiksuara)M0, T1N2M0, T2N2M0, T3N1M0,T3N2M0
Stadi IIIB	T4 çdo NM0, çdo TN3(metastaza në limfonodulat mamare interne)M0 T4 Tumor i cdo lloj dimensionit me infiltrim në paretin torakal apo lëkurë T4a Infiltrim i paretit torakal(brinjë, muskul intercostal,pleura parietale.) T4b Infiltrim i lëkurës(Lëkura e portokallit, nodule satelite në lëkurë) T4c=T4a+T4b T4d Kanceri inflamator
Stadi IV	Çdo TNM1(Metastaza në distancë)

4 .Format klinike te kancerit te gjirit

Kanceri i gjirit paraqitet në 3 forma kryesore që dallojnë ndërmjet tyre nga paraqitja klinike dhe vecoritë prognostike.

Kanceri nodular është forma më e shpeshtë e kancerit të gjirit. Zakonisht e merr pikënisjen në kuadratin e sipërm të jashtëm (48-50%).


Kanceri i tipit inflamator është formë relativisht e rrallë. Karakterizohet nga ecuria e shpejtë dhe malinjiteiti i lartë. Shenjat dalluese të tij janë : zmadhimi dhe forcimi difuz i gjirit, edema dhe skuqja e lëkurës. Këto dukuri mund të shoqërohen dhe me karakteristika të tjera si : futja brenda e thithit të gjirit, adenopati aksilare masive, temperaturë lokale e moderuar. Prekja e njëkohshme e të dy gjinjve dhe prania e metastazave të largëta në momentin e diagnozes vërehet më shpesh se në kanceret e tjerë.

Kanceri i tipit Paget ndeshet në 1-4 % të rasteve. Shenjat e para shfaqen në lëkurën e thithit, e cila trashet, skuqet, lacerohet ose erozionohet duke ngjasuar me një ekzemë të thatë ose të lëngshme. Më vonë thithi shkatërrohet, ulçerimi shtrihet edhe në lëkurën e areolës dhe më vonë shfaqet tumori i cili në stadet fillestare klinikisht mungon. Ecuria e kësaj forme është e ngadalshme, metastazat në nyjet limfatike aksilare ndeshen rrallë dhe prognoza është e mirë për sa kohë kanceri është intraduktal, pa tumor të prekshëm. Me kalimin në fazën invazive ka po atë agresivitet si kanceri nodular [7]

5 Histopatologjia

Kanceri i gjirit e merr prejardhjen nga epiteli që vesh kanalet e qumështit dhe lobulet. Ai ndahet në 2 grupe të mëdha invaziv dhe jo invaziv.

Kanceri joinvaziv lokalizohet në brendësi të strukturave nga e merr prejardhjen, nuk jep metastaza në nyjet limfatike regjionale dhe ka prognozë të mirë. Kanceri invaziv del jashtë paretit të kanaleve dhe lobuleve dhe infiltrohet stromën. Ai jep shpesh metastaza në nyjet limfatike regjionale dhe në distancë. [8]



. Kanceri i gjirit invaziv dhe jo invaziv [8]

Kanceri duktal infiltrativ përbën 55% të rasteve, ndërsa kanceri lobular infiltrativ përbën rreth 25%. Rrallë ndeshen disa isotipe të vecanta si kanceri medular, kolloid (mucinoz), papilar, tubular që kanë prognozë të mirë, vecanërisht izotipi i fundit që është i shërueshëm në 90% të rasteve. Në aspektin morfologjik përvec isotipit ka rëndësi edhe grada e malinjitetit histologjik dhe atij nuklear që kategorizohen si G1 G2 G3. Gjithashtu invazioni i enëve limfatike dhe vazave peritumorale është një veçori e rëndësishme morfologjike e kancerit të gjirit.




Figura 3 . Klasifikimi i kancerit te gjirit [8]

Trajtimi

Trajtimi Kirurgjikal

Kirurgjia mund të përdoret në çdo stad të sëmundjes ,por me pikësnyime të ndryshme. Sipas qëllimeve për të cilat përdoren procedurat kirurgjikale grupohen si më poshtë:

Intervente kirurgjikale kurative të cilat synojnë të heqin tumorin parësor në kufij mikroskopikisht të shëndoshë së bashku me nyjet limfatike regjionale. Këto ndahen në intervente që e heqin gjirin dhe ato që e ruajnë.

Mastektomia radikale konsiston në heqjen “en bloc” të të gjithë gjirit, lëkurës mbi të, muskujve pektoralë dhe nyjeve limfatike aksilare të tre niveleve.

Interventet konservative heqin vetëm tumorin së bashku me një pjesë të indit mamar dhe nyjet limfatike.

Kuadrantektomia konsiston në heqjen e një kuadrati të gjirit ku është vendosur tumori së bashku me lëkurën dhe porcionin përkatës të fascies pektorale. Diseksioni aksilar kryhet në bllok së bashku me kuadratin e gjirit ose me incizion të veçantë nga ai i kuadrantektomisë.

Tumorektomia konsiston në heqjen e tumorit së bashku me indin mamar përreth pa heqje të lëkurës.

Në rast se ndodh recidivë pas kirurgjisë konservative e sëmura i nënshtrohet mastektomisë.

6. Trajtimi sistematik

Trajtimi sistematik i kesaj semundje përfshin modalitete të shumta, si kimioterapinë, hormontherapinë dhe target therapinë e së fundmi therapinë immune . Trajtimi adjuvant është administrimi i terapisë pas interventit kirurgjikal për të vrarë mikro metastazat në momentin e diagnoses primare . Në varësi të modelit të uljes së rrezikut, terapia ndihmëse është vlerësuar të jetë përgjegjëse për 35-72% të uljes së shkallës së vdekshmërisë.

Suksesi i kimioterapisë ndihmëse në kancerin e gjirit filloi pothuajse katër dekada më parë kur Bonadonna et al. në 1976 botoi studimin e parë mbi efikasitetin e ciklofosamidit, metotreksatit dhe fluorouracil (CMF) si trajtim ndihmës për kancerin e gjirit pozitiv.

Studimet e mëvonshme treguan se zëvendësimi i metotreksatit me epirubicin (CEF) ishte edhe më i efektshëm si në aspektin e DFS dhe OS në gratë premenopauzale me kancer gjiri pozitiv node positive . Avantazhi i kombinimeve të skemave që përmbajnë anthraciklin mbi CMF u konfirmua në një meta-analizë të të dhënave individuale për pacientë me kancer të hershëm të gjirit (EBCTCG) . Regjimet e bazuara në antraciklinë me dozë kumulative të konsiderueshme

më të lartë sesa standardi $4 \times AC$ (adriamycina dhe ciklofosfamidi) (psh. CAF (ciklofosfamidi, adriamycina dhe fluorouracil) ose CEF) ishin superiore ndaj CMF standarde .

Kimiopreparatet e grupit te preparative antimikrotubulare (Taxaneve) u pane te rëndësishme në trajtimin me kimoterapi te kancerit gjatë dekadave të fundit.

Regjimet e kombinuara janë një trajtim standard në terapinë adjuvante. Regjimet më të përdorura tregohen në tabelën e mëposhtme.

Tabela 3. Regjimet e kombinuara të kimioterapisë adjuvante për kancerin e gjirit

Regjimi	Doza	Frekuenca	Numri i cikleve
TAC	(T) Docetaksiel – 75 mg/m ² IV dita 1 (A) Doksorubicin – 50 mg/m ² IV dita 1 (C) Ciklofosfamid – 500 mg/m ² IV dita 1	Çdo 21 ditë	6 cikle
AC	Doksorubicin – 60 mg/m ² IV dita 1 Ciklofosfamid – 600 mg/m ² IV dita 1 E ndjekur nga: Paclitaksiel 175 mg/m ² IV dita 1 Në pacientët HER2 +, shtohet Trastuzumab – 4mg/kg dozë ngarkese, 2 mg/kg cdo javë, 6 mg/kg çdo 3 javë	Çdo 21 ditë 40 javë	4 cikle
AC Dose dense	Doksorubicin – 60 mg/m ² IV dita 1 Ciklofosfamid – 600 mg/m ² IV dita 1 E ndjekur nga: Paclitaksiel 175 mg/m ² IV dita 1	Çdo 14 ditë	4 cikle
AC Regjimi metronomik	Doksorubicin – 20 mg/m ² IV Ciklofosfamid – 50 mg/m ² PO E ndjekur nga: Paclitaksiel 80 mg/m ² IV dita 1	Çdo javë Çdo ditë Çdo javë	12 cikle
FEC 100	5 – Fluorouracil – 500 mg/m ² IV dita 1 Epirubicin 100 mg/m ² IV dita 1 Ciklofosfamid – 500 mg/m ² IV dita 1	Çdo 21 ditë	6 cikle

FAC – 1	5 – Fluorouracil – 600 mg/m ² IV dita 1 Doksorubicin – 60 mg/m ² IV dita 1 Ciklofosfamid – 600 mg/m ² IV dita 1	Çdo 21 ditë	4 cikle
FAC – 2	5 – Fluorouracil – 500 mg/m ² IV dita 1 dhe 8 Doksorubicin – 30 mg/m ² IV dita 1 dhe 8 Ciklofosfamid – 100 mg/m ² PO ditët 1 – 14	Çdo 28 ditë	6 cikle
CMF Regjimi Bonadonna	Ciklofosfamid – 100 mg/m ² PO ditët 1 – 14 Metotreksat – 40 mg/m ² ditët 1 dhe 8 5 – Fluorouracil – 600 mg/m ² IV dita 1 dhe 8	Çdo 28 ditë	6 cikle
CMF Regjimi metronomik	Ciklofosfamid – 50 mg/m ² PO ditët 1 – 7 Metotreksat – 15 mg/m ² 5 – Fluorouracil – 300 mg/m ² IV	Çdo javë	24 cikle
TC	Docetaksel – 75 mg/m ² dita 1 5 – Fluorouracil – 600 mg/m ² IV dita 1	Çdo 21 ditë	4 cikle
TCH	Docetaksel – 75 mg/m ² dita 1 Karboplatin – AUC 6 IV dita 1 Trastuzumab – 8mg/kg IV dozë ngarkese e ndjekur nga 6 mg/kg në javë	Çdo 21 ditë	6 cikle 17 cikle
TCH – P	Docetaksel – 75 mg/m ² dita 1 Karboplatin – AUC 6 IV dita 1 Trastuzumab – 8mg/kg IV dozë ngarkese e ndjekur nga 6 mg/kg në javë Pertuzumab – 840 mg IV dozë ngarkese dhe 420 mg në doza njëra pas tjetrës	Çdo 21 ditë	6 cikle 17 cikle 6 cikle

Të dhënat nga provat klinike kanë dokumentuar përfitimet e terapisë adjuvante në përmirësimin e mbijetesës pa sëmundje dhe mbijetesën e përgjithshme për pacientët e diagnostikuar me kancer invaziv të gjirit me Tumore madhësi > 1.0 cm. Përfitimet e terapisë hormonale janë të qarta, por ato janë të kufizuara në pacientët me kancer gjiri me receptorit hormonele positive për estrogenin dhe progjesteronin .

Disa vende kanë raportuar një ulje të shkallës së vdekshmërisë nga kanceri i gjirit për gjatë viteve të fundit. Shkalla e përmirësuar e mbijetesës i përket, të paktën pjesërisht, përdorimit të terapisë sistemike.

Kimioterapia sistemike, me ose pa terapi hormonale të bazuar në karakteristikat biologjike të tumorit, është standardi i trajtimit për pacientët me kancer të gjirit me limfonodula positive , dhe për një pjesë të madhe të atyre me sëmundje node negative dhe tumoreve invazive me diameter >1.0 cm.

Duke pasur parasysh që në kancerin e gjirit risku relapsit në distance është më i madh se recediva lokoregjionale nga të gjitha studimet rezulton që trajtimi sistematik të aplikohet në fillim për shkak të riskut të lartë të metastazimit në distance dhe më pas trajtimi me radioterapi .

Gjithashtu rekomandohet që trajtimi hormonal të aplikohet në mënyrë sequenciale jo paralelisht me kimioterapine dhe radioterapine për shkak të rritjes së ngjarjeve për tromboemboli .Target terapia mund të përdoret paralelisht me trajtimin hormonal ose radioterapine .Rekomandimet për trajtimin adjuvant bazohen në Rekomandimet e San Gallen Consensus Conference 2005 -2007 . dhe National Comprehensive Cancer Network 2007 bazuar në TNM dhe në biologjinë molekulare ..

	St Gallen Consensus conference 2005-2007	National Comprehensive Cancer Network 2007
Her2 Pozitive	Kimioterapi adjuvante	Kimioterapi adjuvante në tumoret > 0.5 cm dhe ose Node pozitive
Her2 negative	ER negative Kimioterapi adjuvante	ER negative .kimioterapi adjuvante për tumoret >1 cm and /or node pozitive

		Te konsiderohet per tumoret 0.5 1 cm nese kemi faktore prognostike si invazioni limfovaskular ose grade e larte
	ER pozitive Kimioterapi adjuvante nese kater ose me shume limfonodula pozitive Te konsiderosh per trajtim nese Tumori > 2 cm ose grade 2 -3 ose mosha me pak se 35 vjec ose kemi invazion limfovaskular.	ER pozitive Kimioterapi adjuvante nese limfonodula pozitive Te konsiderosh per trajtim adjuvant nese tumori eshte >1 cm dhe kemi invazion limfovaskular .

Suksesi i terapisë sistemike varet jo vetëm nga optimizimi i regjimeve terapeutike , por edhe nga vendosja e objektivave si përmirësimi i të kuptuarit të biologjisë tumorale , karakteristikat e pacientëve që ndikojnë në perzgjedhjen e regjimeve te ndryshme ne rezultatin e trajtimit, analizën kritike te rezultateve te studimeve dhe integrimin e të dhënave ne praktiken e perditshme , ndërtimin e konsensusit dhe evidencave , edukimin ne vazhdim në lidhje me perfundimet e këtyre analizave dhe futjen e trajtimeve te reja ne praktiken klinike .

7. Terapia hormonale ne trajtimin adjuvant .

Në kancerin e gjirit të stadi të hershëm me Receptorë Estrogjenik pozitivë (RE +), terapia hormonale luan një rol të rëndësishëm në trajtimin adjuvant, e vetme ose e kombinuar me kimioterapinë. Terapia hormonale ka si qëllim të ulë aftësinë e estrogjenit që të stimulojë mikrometastazat egzistuese ose qelizat kanceroze të fjetura. Terapia hormonale adjuvante mund të reduktojë riskun relativ të rekurencës së kancerit të gjirit kontralateral, ipsilateral, në distancë me 50 % në tumoret me shprehje të lartë të ER. Terapitë hormonale për trajtimin adjuvant të kancerit

të gjirit që janë miratuar nga FDA janë: Tamoksifen dhe inhibitorët e aromatazës (anastrozol, letrozol, exemestan). [30]

7.1 Guidelinet për femrat ne premenopauze

Shoqata Amerikane e Onkologjisë Klinike (ASCO) rekomandoi përdorimin e tamoksifen për femrat premenopauzale, sepse Inhibitorët e Aromatazës janë të kundërlindikuar në femrat me funksion residual ovarial. [31] këto guideline dëshmojnë se, në kohët e sotme rezultati i Supresionit të Funksionit Ovarial (SOF) në këtë popullatë është ende i panjohur dhe nevojiten studime të tjera për të përcaktuar në mënyrë definitive rolin e tij. Guidelinet e NCCN rekomandojnë përdorimin e tamoksifen për 5 vjet (kategoria 1 e evidencës) e shoqëruar ose jo nga supresioni ovarial ose ablacioni (kategoria 2B) nëse një grua është në premenopauzë në momentin e diagnozës.[32] Paneli i ekspertëve St.Gallen rekomandoi vetëm tamoksifen, por pranoi që supresioni ovarial dhe tamoksifen është një alternative e pranueshme për femrat ne premenopauze.[33] Për pacientët që kanë kundërlindikacione ndaj tamoksifenit, ky panel rekomandon supresionin e funksionit ovarial dhe Inhibitorë të Aromatazës. Meta-analiza më e fundit e publikuar nga EBCTCG konfirmoi përfitimin e tamoksifenit në femrat më të reja se 45 vjeç për reduktimin e riskut të rekurencës (HR = 0.63; p = 0.001) dhe mortalitetit nga kanceri i gjirit (HR = 0.71, p = 0.00002). [34]

7.2 Guidelinet për femrat në postmenopauzë

Guidelinet e ASCO rekomandojnë që femrat postmenopauzale me kancer gjiri ER+ duhet të konsiderojnë përdorimin e Inhibitorëve të Aromatazës gjatë terapisë adjuvante, si terapi fillestare ose si terapi sekuenciale (pas 2 ose 3 vjetësh tamoksifen), ose si zgjatje e terapisë adjuvante (pas 5 vjetësh tamoksifen).[31] Këto guideline tregojnë që koha optimal dhe kohëzgjatja e terapisë endokrine ngelen të pazgjidhura, megjithatë ata rekomandojnë trajtimin me 5 vjet me Inhibitorë të Aromatazës në terapinë fillestare dhe në zgjatjen e terapisë adjuvante dhe 5 vjet në total terapi endokrine në gjëndjen sekuenciale. Në terma absolute, reduktimi i riskut për rekurenca nga Inhibitorët e Aromatazës krahasuar me tamoksifen është modeste, më pak se 5 %, ndërsa OS është ekuivalente në studimet e terapisë adjuvante primare dhe të zgjatura. Në 2 nga 6 studime sekunciale, kishte një përmirësim sinjifikant në OS, por diferenca absolute ishte e ulët. Studimet ende nuk kanë përcaktuar me siguri se cila është koha e duhur për të bërë ndërrimin e tamoksifen me një Inhibitor të Aromatazës.

Përfitimet ndaj Inhibitorëve të Aromatazës i përkasin të gjithë klasës, dhe nëse pacienti është intolerant ndaj një bari, ai mund ta ndërrojë me një bar tjetër. Studimet e randomizuara nuk kanë zbuluar markues që mund të parashikojnë përfitimin maksimal ndaj terapisë hormonale adjuvante. Guidelinet e NCCN janë në përputhje me rekomandimet e ASCO.[32] nëse një grua është në postmenopauzë në momentin e diagnozës, opsionet e trajtimit përfshijnë: 5 vjet Inhibitorë të Aromatazës, tamoksifen për 2 – 3 vjet e ndjekur nga Inhibitorë të Aromatazës për të kompletuar 5 vjet terapi hormonale, ose Inhibitorë të Aromatazës për 2 – 3 vjet e ndjekur nga tamoksifen për të plotësuar 5 vjet terapi hormonale. Një tjetër opsion është tamoksifen 4.5 – 6 vjet, e ndjekur nga Inhibitorët e Aromatazës për 5 vjet (evidencë e kategorisë 1). Nëse një pacient ka kundërinidkacione ndaj Inhibitorëve të Aromatazës, nuk e toleron dot ose refuzon ta marrë, duhet të konsiderohet tamoksifen për 5 vjet.

7.3 Tamoksifen

Tamoksifen është një modulator selektiv i receptorëve të estrogenit (SERM) që frenon rritjen e kancerit të gjirit duke antagonizuar në mënyrë konkurruese receptorët e estrogenit =, duke u lidhur vetë me një nga dy rajonet aktivizuese të receptorit. Ai vepron duke frenuar translokacionin dhe lidhjen në bërthamë të receptorit të estrogenit. Tamoksifen, që administrohet si tabletë orale 20 mg një herë në ditë, mund të ketë efekte estrogenike agoniste, agoniste parcial dhe antagonist, që përgjigjen për risqet dhe efektet përfituese. Efektet agoniste janë përgjegjëse për rritjen e incidencës së trashjes endometriale dhe kancerit, si dhe ruajtjes së densitetit mineral kockor në femrat postmenopauzale, si dhe reduktim të nivelit të kolesterolit. Efektet anësore më të zakonshme të tamoksifenit përfshijnë : afshe të nxehta, rrjedhje vaginale, dhe rritje e riskut për sëmundje tromboembolike (tromboza venoze të thella, emboli pulmonare).

Tamoksifen ka qënë standarti i artë i terapisë hormonale adjuvante për kancerin e gjirit për rreth 30 vjet. Metaanaliza nga EBCTCG përfshiu të dhëna nga 20 studime (N = 21,457) në terapi adjuvante me tamoksifen për rreth 5 vjet dhe pa terapi adjuvante me tamoksifen.[34] Për pacientët me sëmundje me ER + (n = 10,645), tamoksifen ka reduktuar ritmin e rekurencës me 39 % (RR = 0.61, p < 0.00001). Tamoksifeni ka përgjysmuar riskun e rekurencës gjatë viteve 0 – 4 (RR = 0.53) dhe e ka reduktuar atë me 1/3 gjatë viteve 5 – 9 (RR = 0.68, p < 0.00001). pas vitit të 10, ritmi i rekurencës ishte i ngjashëm në të dy grupet. Përfitimet e tamoksifenit ishin të pavarura nga statusi i receptorëve të progesteronit, mosha, statusi nodal, grada e tumorit, diametric i tumorit, përdorimi

i kimioterapisë. Tamoksifen ka treguar një përfitim të rëndësishëm edhe në pacientët me nivel të ulërt të ER. Tamoksifen ka ulur mortalitetin e kancerit me 1/3 gjatë 15 viteve të para. Tamoksifen ka reduktura edhe riskun erekurencës lokale, kancerin e gjirit kontralateral dhe rekurencat në distancë.

Kohëzgjatja e terapisë me tamoksifen është 5 vjet. Studimi B – 14 nga NSABP, ku morën pjesë 2892 femra me kancer gjiri ER+, nyje limfatike negative, i randomizoi për të marrë tamoksifen ose placebo për 5 vjet. Ndjekja afatgjatë tregoi se gjatë 15 vjetëve, femrat kishin përfitim nga trajtimi me tamoksifen për 5 vjet, në terren të mbijetesës së lirë pa relaps (RFS) (HR = 0.58) dhe OS (HR = 0.8). Ky përfitim ishte i pavarur nga mosha, statusi i menopauzës dhe niveli i ER. [35] Trajtimi me tamoksifen për 5 vjet është treguar të jetë me përfitim më të madh sesa tamoksifen për 1 – 2 vjet. Zgjatja e tamoksifen për më shumë se 5 vjet nuk ka treguar ndonjë përfitim të madh. Në studimin B – 14 nga NSABP, 1172 femra që ishin të lira nga sëmundja pas 5 vjetësh terapi me tamoksifen u randomizuan për të marrë ose placebo, ose një terapi shtesë me tamoksifen për 5 vjet. Në një ndjekje prej 7 vjet nga randomizimi, kishte një avantazh të lehtë në DFS (82 % kundrejt 78 %, $p = 0.03$), RFS (94 % kundrejt 92 %, $p = 0.13$) dhe OS (94 % dhe 91 %, $p = 0.07$) për femrat që ndërprejnë tamoksifen.[36] Studimi skocez gjithashtu nuk tregoi avantazh të vazhdimin të tamoksifenit përtej 5 vjetëve, me një përkeqësim jositifikant gjatë zgjatjes së përdorimit përtej 5 vjet (HR = 1,27). [37] Ndërkohë rezultate të ndryshme janë paraqitur në 2 studime të tjera: ATLAS [38] dhe aTTom [39]. Studimi ATLAS randomizoi 11,500 femra (59 % ER+, 41 % të patestuara) që ishin të lira nga sëmundja pas 5 vjetësh tamoksifen që e kishin vazhduar tamoksifen për 5 vjet të tjera ose e kishin ndaluar atë. Me një ndjekje 5 vjeçare, kohëzgjatja më e madhe e tamoksifen shoqërohej me reduktimin e riskut relativ të rekurencës me 12 % (HR = 0.88, $p = 0.05$). Studimi aTTom randomizoi 6934 femra (39 % ER+, 61 % të patestuara) në përfundim të 4 ose më shumë vitesh me tamoksifen që kishin ndërprerë terapinë ose që kishin vazhduar për 5 vite shtesë. Me një ndjekje mediane prej 4.2 vitesh, kishte një avantazh të lehtë dhe jositifikant të zgjatjes së terapisë për 10 vjet (RR = 0.94; 0.81 – 1.09; $p = 0.4$). Kohëzgjatja optimale e terapisë nuk dihet, por është të paktën 5 vjet.

7.4 Supresioni/Ablacioni ovarial

Supresioni ovarial (SO) ose ablacioni ovarian (AO) mund të përdoret në trajtimin e kancerit të gjirit në femrat premenopauzale. AO mund të realizohet nëpërmjet kirurgjisë (ooforektomi) ose

radioterapisë; SO mund të realizohet me anë të barnave (agonistë të LHRH). Metaanaliza e EBCTCG përfshiu 8000 femra më të reja se 50 vjeç me ER+ ose status ER të panjohur. Për femrat që kishin aplikuar SO/OA, kishte një rënie sinjifikante në rekurencën 15 vjeçare të kancerit të gjirit ($p < 0.00001$) dhe mortalitet ($p = 0.004$) krahasuar me ata që nuk kishin marrë terapi ovariale. Terapi ovariale kishte një efekt më të vogël në studimet në të cilat të dy grupet kishin marrë kimioterapi. Nuk kishte tregues që efektet e AO ndryshonin nga efektet e SO. [40] Një metaanalizë u realizua në 11,906 gra premenopauzale (9022 HR+) nga 16 studime klinike që përfshinin agonistë të LHRH, me një ndjekje mediane prej 6.8 vjetësh. Kur agonistët e LHRH ishin përdorur të vetëm dhe krahasuar me grupin pa terapi sistemike, nuk kishte rënie sinjifikante të riskut të rekurencës së kancerit të gjirit, megjithëse mostra e studiuar ishte e vogël ($n = 338$). [41] Në 407 pacientë, SO dhe tamoksifen e reduktuan në mënyrë sinjifikative rekurencën dhe vdekjet pas rekurencës krahasuar me grupin që nuk morën trajtim, por efektet mund të kenë qënë për shkak të tamoksifen. Në 1013 pacientë, shtimi i agonistëve të LHRH tek tamoksifen nuk e uli riskun e rekurencës ($HR = 0.85$, $p = 0.02$) dhe vdekjes pas rekurencës ($HR = 0.85$, $p = 0.08$). Kur agonistët e LHRH u krahasuan me kimioterapinë ($n = 3184$), kishte një reduktim të ngjashëm të rekurencës dhe vdekjeve pas rekurencës. Krahasimi i agonistëve të LHRH plus tamoksifen me kimioterapinë pa tamoksifen nuk tregoi diferenca sinjifikative ($n = 1577$). Kishte një përfitim nga agonistët e LHRH pas kimioterapisë në femrat më të reja se 40 vjeç, në të cilat kimioterapia ishte më pak e mundshme të shkaktonte amenorre primare. E rëndësishme në këtë metaanalizë ishte fakti që nuk kishte studime që krahasonin agonistët e LHRH me kimioterapinë + tamoksifen në të dy krahët.

Qendra e Kancerit në Ontario (CCO) publikoi guideline në ablacionin ovarial adjuvant në trajtimin e femrave premenopauzë me kancer gjiri invaziv të stadit të hershëm. [42] Këto guideline deklarojnë se AO/SO nuk rekomandohet si shtesë e terapisë sistemike me kimioterapi, tamoksifen, ose kombinimin kimioterapi dhe tamoksifen. Ata gjithashtu theksojnë se SO/AO e vetme nuk rekomandohet si alternative e ndonjë forme tjetër teraapie sistemike dhe duhet të konsiderohet vetëm për femrat që nuk do marrin terapi sistemike (që e refuzojnë ose nuk e tolerojnë). Në rastin e agonistëve të LHRH sugjerohet injeksioni mujor.

7.5 Inhibitorët e aromatazës

Inhibitorët e aromatazës janë një klasë barnash që bllokojnë shndërrimin periferik të androgjenëve në estrogen. Ky mekanizëm veprimi i jep avantazhin e përdorimit në femrat postmenopauzale, në

të cilat prodhimi i estrogenit është nëpërmjet aromatizimit periferik, sidomos në indin subkutan. Barnat më të përdorshëm janë: anastrozol, letrozol, exemestan, dhe janë të gjeneratës së tretë. Efikasiteti i tyre është i krahasueshëm me njëri-tjetrin, pavarësisht diferencave në mekanizmin e veprimit.

Inhibitorët e aromatazës konsiderohen pjesë e terapisë endokrine për femrat postmenopauze me ER+, dhe kancer gjiri të stadit të hershëm. Studimet adjuvante të IA mund të ndahen në 3 kategori:

- Terapi fillestare: krahasimi kokë më kokë i IA me tamoksifen për 5 vjet
- Terapi sekuenciale : Krahasimi i tamoksifen për 2 – 3 vjet e ndjekur nga një IA për të plotësuar 5 vjet kundrejt tamoksifen për 5 vjet ose kundrejt IA për 5 vjet
- Terapia adjuvante e zgjatur: Vlerësimi i përfitimit të shtimit të IA pas 5 vjetësh tamoksifen

EBCTG realizoi një metaanalizë e studimeve të randomizuara të IA krahasuar me tamoksifen. Në dy studime të randomizuara prospektive që përfshinin 9856 pacientë, IA u krahasuan me tamoksifen si monoterapi. Me një kohë mesatare ndjekje 5.8 vjetësh, kishte një reduktim sinjifikant të rekurencës por jo mortalitetit të kancerit të gjirit. Në 4 studime, që përfshinin 9015 pacientë që u randomizuan pas 2 – 3 vjetësh tamoksifen ose të vazhdojnë të përdorin tamoksifen ose ta ndërrojnë me një IA, në total 5 vjet terapi endokrine. Me një kohë mesatare të ndjekjes 3.9 vjet, ndërrimi me AI tregoi një reduktim të riskut të rekurencës dhe mortalitetit. Nuk kishte diferenca në përfitime të lidhura me moshën, statusin e nyjeve, gradën e tumorit ose statusin e receptorëve të progesteronit. [43]

Një tjetër metaanalizë e pavarur e studimeve që krahasojnë IA me tamoksifen ekzaminoi 9 studime të kontrolluara e të randomizuara, që përfshijnë 28,632 gra dhe analizuan të treja strategjitë e trajtimit: monoterapi, terapi sekuenciale dhe terapi e zgjatur. DFS ishte më e lartë në mënyrë sinjifikative për IA si monoterapi dhe terapi sekuenciale. Nuk kishte diferenca në OS ndërmjet monoterapisë dhe terapisë së zgjatur, por OS ishte e zgjatur në pacientët që ndërruan terapinë nga tamoksifen në IA. Konkluzioni i kësaj metaanalize ishte se terapia sekuenciale rezulton të jetë terapia e përzgjedhur. [44]

Studimi ATAC ishte studimi i parë që tregoi përfitim të një IA (anastrozol) ndaj tamoksifenit. [45] Në këtë studim dyfish të verbër, të kontrolluar me placebo, u randomizuan 9366 gra postmenopauzale që të merrnin vetëm anastrozol, vetëm tamoksifen ose kombinimin e të dy

barnave për 5 vjet. Krahu i kombinimit u mbyll për shkak të inferioritetit. Me një ndjekje mediane prej 120 muajsh, endpoint primar i studimit ishte DFS, e cila ishte me e gjatë në mënyrë sinjifikative me anastrozol. Anastrozol ishte i shoqeruar me një kohë më të gjatë drejt rekurencës, kohë më e gjatë drejt rekurencave në distancë dhe ulje e kancerit në gjirin kontralateral. Këto ndryshime ishin më të mëdha në 2 vitet e para të terapisë aktive, por gjithsesi ruhen në mënyrë të qëndrueshme në të gjithë periudhën e folloë up, dhe në mënyrë persistente pas përfundimit të trajtimit. Nuk kishte diferenca sinjifikative në OS.

Studimi BIG 1 – 98 tregoi se letrozol kishte më shumë përfitime sesa tamoksifen. [46] ky ishte një studim i fazës III, dyfish i verbër, ku morrën pjesë 8010 gra postmenopauzale me kancer gjiri me receptorë hormonalë pozitiv, të cilat u randomizuan në terapi hormonale për 5 vjet në një nga katër krahët e mëposhtëm: tamoksifen, letrozol, tamoksifen për 2 vjet e ndjekur nga letrozol për 3 vjet, letrozol për 2 vjet e ndjekur nga tamoksifen për 3 vjet. Endpoint primar ishte DFS. Krahu i monoterapisë përfshinte 4922 gra. Me një median ndjekje 51 muaj, kishte një avantazh në DFS për letrozol krahasuar me tamoksifen. [47] Një analizë e ndjekjes për 71 muaj tregoi një diferencë josinjifikative në OS duke favorizuar letrozol.[48]

8. Profili molekular i kancerit të gjirit

Kanceri i gjirit është një sëmundje e cila karakterizohet nga alterime molekulare të shumta. Disa markues molekularë përdoren për qëllime diagnostike, prognostike dhe si faktorë parashikues për trajtimin .

Zbulimi për herë të parë në vitin 1994 i gjeneve BRCA1 , hodhi dritë mbi trashëgueshmërinë e mutacionit në gjenet BRCA1 dhe BRCA2 si faktorë risku. Këto gjene supresore të tumorit përfshihen në funksione kritike, si përgjigja ndaj dëmtimit të ADN dhe riparimi i ADN.

